



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

MINISTRIA PËR DIALOG

RAPORT MBI GJENDJEN NË ZBATIMIN E MARRËVESHJEVE TË BRUKSELIT

1 janar – 15 qershor 2016

RAPORTI I DORËZUAR NË BASHKIMIN EVROPIAN/SHËRBIMIN EVROPIAN PËR
VEPRIM TË JASHTËM

NGA QEVERIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Prishtinë, 15 qershor 2016

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport periodik i prezantuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës ofron një vlerësim mbi gjendjen e tanishme në Dialogun e Brukselit dhe përfshinë periudhën nga data 1 janar deri më 15 qershor 2016. Ky raport vlerëson progresin e përgjithshëm dhe sfidat në zbatimin e Marrëveshjeve të Brukselit, si dhe trajton secilën marrëveshje në aspektin e obligimeve të palëve përkatëse të marra përsipër në kuadër të Dialogut të Brukselit.

Qeveria e Republikës së Kosovës i kushton rëndësi të madhe dialogut të Brukselit sepse ky dialog kontribuon në paqe dhe stabilitet në rajon, marrëdhënie të mira fqinjësore dhe bashkëpunim rajonal, si dhe kontribuon në avancimin e qëllimeve tona drejt integritit euroatlantik të Kosovës për të mirën e qytetarëve.

Dialogu i Brukselit ka kontribuar në avancimin e rrugës së Kosovës drejt integritit evropian. Kosova filloi rrugëtimin e saj zyrtar drejt integritit në BE me rastin e vendosjes së marrëdhënieve kontraktuale me BE-në, përmes nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit me BE-në, marrëveshje kjo e cila ka hyrë në fuqi në prill të këtij viti. BE-ja ka marrë vendim për rekomandimin e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës, duke realizuar kështu ëndrrën e tyre për lirinë e lëvizjes, si evropianët më të rinj. Këto janë arritje të mëdha të cilat e vërtetojnë suksesin e Kosovës në përmbushjen e standardeve të kërkuara evropiane, duke marrë përsipër më shumë përgjegjësi dhe motivim për t'i çuar përpara reformat evropiane në vend.

Në aspektin e zbatimit të marrëveshjeve të Brukselit, kjo periudhë raportuese nuk ka shënuar ndonjë përparim substancial. Kosova ka qenë efektive në përmbushjen e detyrimeve të saj dhe ka bashkëpunuar ngushtë me BE-në për ta çuar përpara procesin e zbatimit të marrëveshjeve. Megjithatë, e njëjta nuk mund të thuhet edhe për Serbinë e cila praktikisht ka bllokuar procesin e zbatimit, duke mos bërë ndonjë lëvizje të rëndësishme në përmbushjen e detyrimeve të saj. Kjo sidomos në lidhje me marrëveshjen për kodin shtetëror për Kosovën dhe marrëveshjen për funksionimin e pavarur të sistemit të transmisionit të energjisë së Kosovës (KOSTT), të dyja këto marrëveshje janë bllokuar nga Serbia. Këto dy marrëveshje janë të një rëndësie të madhe për Kosovën dhe kanë qenë në tryezën e negociatave për më shumë se pesë vjet. Serbia ka vonuar edhe heqjen e barrikadës ("Parkut të paqes") nga Ura e Ibrit në Mitrovicë për shkak se BE-ja nuk ka qenë në gjendje të fillojë revitalizimin e urës, për të cilën është rënë dakord të përfundojë jo më vonë se në qershor të vitit 2016. Si përgjigje ndaj këtyre bllokadave, Kosova nuk ka ndërmarrë ndonjë hap rreth zbatimit të marrëveshjes për Asociacionin.

Më 1 mars të këtij viti ishte rënë dakord që ITU-ja të ndaj kodin shtetëror telefonik për Kosovën (383). Austria ka aplikuar me kohë për kodin shtetëror telefonik të Kosovës në ITU (në janar të këtij vitit). Kosova i ka përmbushur të gjitha detyrimet e saj rreth zbatimit, por Serbia bllokoi procesin duke mos përmbushur pjesën e saj të obligimeve.

Sa i përket energjisë, më 1 tetor të vitit 2015, Kosova/KOSTT nënshkroi marrëveshjen me ENTSO-E, një marrëveshje që përcakton që KOSTT të operojë si një sistem i pavarur i transmisionit, në përputhje me marrëveshjen e Brukselit të vitit 2013 për energjinë. KOSTT duhej të fillonte së operuari si një sistem i pavarur që në muajin shkurt, megjithatë, Serbia ka bllokuar këtë proces pasi që nuk ka arritur të regjistrojë një kompani të re për furnizim me energji elektrike në pajtim me ligjin e Kosovës, siç parashikohet nga marrëveshja për energjinë.

Padyshim, Serbisë i mungon vullneti politik për t'i respektuar marrëveshjet e Brukselit për telekomun dhe energjinë, gjë për të cilën dëshmon historia pesëvjeçare e negociatave për këto dy çështje. Pa rezultate ka qenë edhe përpjekja e fundit për rrugëdalje nga BE-ja, përmes marrëveshjeve të 25 gushtit të vitit 2015, marrëveshje të cilat kishin për qëllim përsheptimin e zbatimit të marrëveshjeve për telekomun dhe energji, të nënshkruara në vitin 2013. Asnjë justifikim që Serbia mund të përpiqet ta paraqesë duke përdorur pretekstin e zgjedhjeve në Serbi të mbajtura më 24 prill të këtij viti nuk qëndron, sepse afatet zbatuese (në fakt, afatet e zgjatura) kanë qenë para periudhës së zgjedhjeve atje.

Qeveria e Republikës së Kosovës e ka informuar rregullisht BE-në për bllokadat e lartpërmendura nga Serbia dhe, megjithëse kemi kërkuar nga BE-ja që të shtoj përpjekjet e saj për zhbllokimin e këtij procesi, për fat të keq nuk është arritur ndonjë progres deri më tani. Ana pozitive është se BE-ja ka njohur performancën e Kosovës në përmbushjen e obligimeve zbatuese. BE-ja ka bërë të gjitha përpjekjet për zhbllokimin e procesit dhe po vazhdon ta bëjë këtë. Për këtë qëllim, BE-ja ka organizuar disa takime teknike në Bruksel në përpjekje që të arrihet një përparim drejt zbatimit, por, këto takime vetëm sa treguan edhe një herë mungesën e vullnetit politik nga ana e Serbisë për t'i përmbushur detyrimet e saj.

Si përgjigje ndaj bllokadave të Serbisë, Kosova e ka bërë të qartë se nuk do të ndërmerr asnjë veprim për zbatimin e Marrëveshjes për asociacionin e komunave me shumicë serbe në Kosovë, para se Serbia të heq bllokadën për kodin telefonik për Kosovën dhe funksionimin e pavarur të KOSTT-it, si dhe para se të largohet barrikada nga Ura e Ibrit në Mitrovicë.

Qeveria e Kosovës deklaroi se sapo të largohen bllokadat e lartpërmendura, do të zbatojë detyrimet e saj lidhur me zbatimin e Marrëveshjes për Asociacionin. Asociacioni nuk do të ketë asnjë kompetencë ekzekutive dhe nuk duhet të jetë një nivel i tretë i qeverisjes në Kosovë, për shkak se kjo nuk përcaktohet në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet përkatëse të Kosovës. Rrjedhimisht, statuti i Asociacionit do të jetë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës, si dhe me Vendimin e 26 dhjetorit të vitit 2015 të Gjykatës Kushtetuese. Pajtueshmëria e Marrëveshjes për Asociacionin me Kushtetutën e Kosovës parashikohet në pikën 2 të kësaj Marrëveshjeje. Qeveria e Kosovës e sheh Asociacionin si një strukturë ligjore që do t'i ndihmojë komunat për t'i koordinuar më mirë çështjet komunale dhe të ndihmojë në riintegrimin e

komunitetit serb në sistemin e Kosovës. Qeveria e Kosovës e ka bërë të qartë se themelimi i Asociacionit është i kushtëzuar me shpërbërjen e plotë dhe të verifikuar të strukturave paralele të mbetura të Serbisë në Kosovë. Asociacioni nuk mund të themelohet në një situatë që vazhdon të jetë paradoksale ku në të njëjtën kohë veprojnë komunat legale si dhe ato ilegale në Kosovë.

Ne vërejmë me shqetësim se Serbia vazhdon të mbështesë aktivitetet e strukturave të saj paralele në komunat e Kosovës duke shkelur kështu Marrëveshjen e Brukselit të vitit 2013 për normalizimin e marrëdhënieve mes dy shteteve. Përveç kësaj, Serbia vazhdon të ndërhyjë në komunat legale në veri të Kosovës duke i penguar ato që të funksionojnë në përputhje të plotë me ligjet e Kosovës. Këto komuna nuk i kanë miratuar ende simbolet dhe vulat e përcaktuara me ligjet e Kosovës dhe madje as buxhetet e tyre nuk janë në përputhje të plotë me ligjet e Kosovës, në përpjekje për ta mbajtur sektorin e arsimit dhe shëndetësisë jashtë financimit nga të Kosovës.

Në mënyrë të ngjashme, liria e lëvizjes në Urën e Mitrovicës nuk është vendosur ende. Largimi i barrikadës dhe rivitalizimi i Urës së Mitrovicës i paraparë që të përfundohet në fund të qershorit të vitit 2016 nuk ka shënuar ndonjë progres të dukshëm për shkak të pengesave nga Serbia. Zyra e BE-së në Kosovë, e cila është përgjegjëse për rivitalizimin e urës nuk ka filluar punën ende, siç parashihet në marrëveshjen e Brukselit të 25 gushtit të vitit 2015. Serbia po përpiqet ta pengojë këtë çështje duke mos lejuar kryetarin e Mitrovicës veriore që ta nënshkruajë një Memorandum të Mirëkuptimit me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, që konfirmon se vija administrative midis Mitrovicës jugore dhe veriore, është në përputhje me Ligjin e Kosovës.

Në tetor të vitit 2016 është planifikuar të mbahet regjistrimi i popullsisë në katër komunat veriore. Ne kërkojmë mbështetje nga BE-ja për të siguruar që Serbia nuk do ta pengojë procesin. Në fillim të vitit 2014 ishte arritur marrëveshja për regjistrim në këto komuna, në mes të kryetarëve ligjor të këtyre komunave dhe Qeverisë së Kosovës, me praninë e Ambasadës Amerikane dhe Zyrës së BE-së, në këmbim të lejitimit që këto dy komunat ta rrisin numri i këshilltarëve komunal pasi u ankuar se numri aktual nuk reflekton proporcionalitetin e popullsisë së këtyre dy komunave (Zveçanit dhe Zubin Potokut). Megjithatë, kryetarët e këtyre katër komunave, të ndikuar negativisht nga Serbia, nuk janë duke bashkëpunuar në këtë çështje. Qeveria ka miratuar projektligjin për regjistrimin e popullsisë dhe Kuvendi i Kosovës është në proces të miratimit.

Për më tepër, duhet theksuar se Serbia po shkel parimet e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve, të përcaktuara në Marrëveshjen e Brukselit të vitit 2013 (Pika 14) duke përdorur një qasje destruktive dhe anti-evropiane kundër integritit të Kosovës në organizatat evropiane dhe ndërkombëtare, siç ishte rasti i UEFA, FIFA dhe më herët UNESCO. Megjithatë, Kosova fitoi mbështetjen e shumicës dhe u bë anëtare me të drejta të plota në UEFA dhe FIFA. Kosova u anëtarësua në Gjykatën e përhershme të arbitrazhit më 14 qershor 2016, përkundër përpjekjeve kundërshtuese të Serbisë, si dhe një numër të organizatave ndërkombëtare.

Zhvillime pozitive janë shënuar në procesin e finalizimit të zbatimit të marrëveshjeve për çështjet që kanë të bëjnë me drejtësinë dhe të ashtuquajturën "mbrojtja civile", rreth ndërtimit të objekteve të përhershme të MIK (IBM), etj.

Sa i përket "Mbrojtjes civile", zbatimi pothuajse ka përfunduar, kjo strukturë ilegale është shuar më 11 janar 2016, ish personeli i saj është integruar në institucionet civile të Kosovës në nivelin qendror. Nga gjithsej 483 persona, 433 kanë nënshkruar kontratat e punës me Qeverinë e Kosovës dhe 50 tjerët janë në proces të nënshkrimit të kontratës.

Lidhur me drejtësinë, Kosova është duke e finalizuar procesin e konsolidimit të sistemit unitar të drejtësisë në komunat veriore të vendit, ku do të vendosen një gjykatë themelore dhe një zyre prokurorie për t'i shërbyer shtatë komunave, në përputhje me ligjet e Kosovës, siç parashihet me Marrëveshjen e Brukselit. Strukturat paralele të drejtësisë janë mbyllur dhe ish personeli i tyre është duke u integruar në sistemin e drejtësisë në Kosovë (gjyqtarë, prokurorë, staf administrativ).

Në këtë periudhë është arritur një marrëveshje e re për njohjen reciproke të certifikatave të import-eksportit të mallrave të rrezikshme (certifikatave ADR), një marrëveshje e cila është duke u zbatuar në tërësi. Ende ka çështje të pazgjidhura për t'u zbatuar, sidomos në fushën e lirisë së qarkullimit, çështje e cila mbetet të trajtohet në periudhën e ardhshme.

Qeveria e Kosovës konsideron se zbatimi i marrëveshjeve është kyç për suksesin e këtij dialogu. Kërkojmë nga BE si lehtësuese dhe garantuese e Marrëveshjes së Brukselit që të kërkojë qëndrueshmëri dhe efektivitet të palëve ndaj detyrimeve të tyre të zbatimit, si e vetmja rrugë që çon në arritjen e qëllimeve të dialogut të Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve mes dy shteteve. Mendojmë se normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë mund të përparojë duke siguruar mosndërhyrje në sovranitetin e njëri-tjetrit, pra duke detyruar Serbinë që të ndal ndërhyrjet në Kosovë përmes shpërbërjes së strukturave të saja paralele të mbetura.

E vlerësojmë lartë përkrahjen e BE-së dhe rolin e saj lehtësues në këtë dialog, si dhe mbështetjen e plotë nga SHBA-ja, Gjermania dhe të gjitha vendet e tjera anëtare të BE-së.

Me respekt,



Edita Tahiri
Ministre për Dialog
Kryenegociatore në Dialogun e Brukselit

Përmbajtja

Përmbledhje Ekzekutive	2
1. Telekomit – Kodi shtetëror për Kosovën	7
2. Energjia – Operimi i pavarur i KOSTT	8
3. Largimi i barrikadës nga Ura e Mitrovicës	9
4. Funksionimi i brishtë i katër komunave veriore në Kosovë	10
5. Strukturat paralele të Serbisë në Kosovë ende nuk janë shuar	11
6. Asociacioni	13
7. Shpërbërja e “Mbrojtjes civile”	14
8. Siguria – Policia	15
9. Themelimi i Zyrave të Agjencisë për Regjistrim Civil në komunat veriore	16
10. Drejtësia	16
11. Zyrat ndërlidhëse (ZN) dhe vizitat zyrtare bilaterale	19
12. Dogana / Tregtia e Lirë	20
13. Liria e lëvizjes	21
14. MIK – ndërtimi i objekteve të përhershme	22
15. Kadastru	23
16. Mbledhja e të hyrave doganore	24
17. Fondi zhvillimor	24
18. Bashkëpunimi rajonal	24
19. Diplomati	26
20. Sigurimi i automjeteve	27
21. Certifikatat e produkteve farmaceutike (CPF)	28
22. Regjistrimi i bizneseve në komunat veriore të Kosovës	28
23. Certifikatat ADR	29
Lista e shkurtesave	

GJENDJA NË ZBATIMIN E MARRËVESHJEVE

1. TELEKOMI – KODI SHTETËROR PËR KOSOVËN

Serbia ka bllokuar kodin shtetëror për Kosovën, edhe pse sipas marrëveshjes afati për ndarjen e kodit telefonik nga ITU ishte më 1 mars 2016. Ky faktikisht është afati i dytë sepse afati i parë i paraparë më 1 janar 2015 është shtyrë për shkak të vonesave nga ana e Serbisë në regjistrimin e kompanisë së re në Kosovë. Regjistrimi i kompanisë së re është bërë në përputhje me ligjin e Kosovës ashtu siç është përcaktuar me marrëveshjen për Telekomin dhe ky ishte parë si një hap i mirë i progresit drejt zbatimit. Megjithatë, që nga atëherë Serbia ka ndërprerë bashkëpunimin mbi zbatimin si dhe nuk ka dërguar letër të zotimit tek ITU për moskundërshtimin e kodit shtetëror të Kosovës. Serbia nuk respekton Marrëveshjet e Brukselit për telekomun kryesisht për shkak të mungesës së vullnetit politik. Kjo mund të shihet nga fakti që marrëveshja e telekomit është në tryezën e dialogut për më shumë se pesë vite dhe akoma nuk është zbatuar.

Kosova nga ana e saj ka përmbushur obligimet që dalin nga marrëveshja për telekomun. Në harmoni me hapat e dakorduar në planin e veprimit, Kosova ka regjistruar me kohë kompaninë e re për telekomun në përputhje me ligjin e Kosovës. Pas aplikimit të Austrisë për kodin telefonik për Kosovën në ITU (më 4 janar 2016) siç është dakorduar, Qeveria e Kosovës ka marrë vendim për udhëzimin e Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) që të lëshoj një autorizim të përkohshëm me fushëveprim të kufizuar për shërbimet mobile për kompaninë e re dhe licencë të plotë për shërbimet e telefonisë fikse në janar të vitit 2016. Një kopje e vendimit është dërguar tek ndërmjetësi i BE-së.

ARKEP ka përmbushur obligimet e tij teknike për përgatitjen e draft vendimeve për licencim dhe është angazhuar në një bashkëpunim konstruktiv me ndërmjetësuesin e BE-së për të siguruar që licencimi është në përputhje me marrëveshjen e Brukselit dhe ligjin e Kosovës. Sa i përket licencës për telefoninë fikse, ARKEP tashmë ka lëshuar konfirmimin e njoftimit (Autorizimin e Përgjithshëm) për ofrimin e shërbimeve të telefonisë fikse me 22 janar 2016 dhe e ka dërguar tek ndërmjetësi i BE-së. Sa i përket autorizimit të përkohshëm për telefoninë mobile, ARKEP ka lëshuar një konfirmim të njoftimit për autorizim të përkohshëm më 22 janar 2016 dhe e ka dërguar tek ndërmjetësi i BE-së.

Përpyekjet e BE-së për të shtyrë përpara zbatimin nuk kanë qenë të suksesshme. Në këtë periudhë raportuese janë realizuar pesë takime të grupit punues për telekomun në Bruksel, pa asnjë rezultat konkret. (më 18 janar, 26 janar, 18 shkurt, 23 dhe 24 shkurt dhe i fundit më 27 maj 2016). BE-ja ka konstatuar që Serbia nuk është duke respektuar marrëveshjen.

2. ENERGJIA – OPERIMI I PAVARUR I KOSTT

Serbia ka bllokuar zbatimin e marrëveshjes për energji e cila ka paraparë operimin e KOSTT si operator i pavarur i sistemit të transmisionit të energjisë, më 6 shkurt 2016. Në bazë të marrëveshjes KOSTT-ENTSO-E të datës 1 tetor 2015 që rrjedh nga Marrëveshja për energjinë e vitit 2013 e nënshkruar në Bruksel, KOSTT është dashur të fillojë operimin në mënyrë të pavarur në dhjetor të vitit 2015 dhe afati i dytë ishte 6 shkurt 2016. Serbia e ka bllokuar këtë duke e zvarritur regjistrimin e kompanisë së re për furnizim në përputhje me ligjin e Kosovës, siç kërkohet me marrëveshjen për energjinë. BE-ja, si ndërmjetësues dhe garantues i marrëveshjeve, është informuar rregullisht për situatën; megjithatë, deri më tani nuk ka pasur ndonjë progres, përkundër disa përpjekjeve të BE-së për të diskutuar çështjen me Serbinë.

Në fakt, Serbia ka dështuar katër herë të regjistroj dy kompanitë e reja (njëra për tregti dhe tjetra për furnizim dhe shërbime të mirëmbajtjes) në Kosovë në bazë të marrëveshjes së vitit 2013 për energjinë. Dështimet e Serbisë duken që janë për arsye politike pasi që heziton që ti regjistroj kompanitë e reja në përputhje me ligjin e Kosovës, siç parashihet me marrëveshjen e Brukselit për energjinë, e cila në pikën 4 thotë “të dyja palët dakordohen që një kompani e tillë do të themelohet sipas kornizës ligjore dhe rregullative të Kosovës.”

Kosova i ka bërë thirrje BE që të kërkoj nga ENTSO-E që të shfuqizojë kushtëzimin e KOSTT për fillimin e operimit si OST i pavarur me regjistrimin e kompanive të reja sepse ishte Serbia ajo që ka dështuar të regjistroj kompanitë e reja. Ministria për Dialog, Edita Tahiri, ka ngritur këtë çështje dhe ka dërguar letra tek BE-ja duke kërkuar zgjidhjen e kësaj çështje, duke pasur parasysh që Kosova ka përmbushur obligimet e saj. Për fat të keq, nuk është arritur progres deri më tani.

Në anën tjetër, KOSTT ka plotësuar të gjitha kriteret dhe kushtet teknike për kyçje në sistemin evropian ENTSO-E sipas marrëveshjes së datës 1 tetor 2015 për të filluar operimin si zonë/bllok kontrollues.

Sa i përket vonesave në zbatimin e marrëveshjes për kyçje KOSTT-ENTSO-E, është dërguar një letër nga KOSTT tek ENTSO-E, si dhe letra e përbashkët nga KOSTT dhe OST e Shqipërisë më 5 maj 2016. Qeveria e Kosovës dhe KOSTT kanë ofruar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, duke garantuar sigurinë e furnizimit të energjisë elektrike për të gjithë qytetarët e Kosovës, përfshirë pjesën veriore të Kosovës më 31 maj 2016.

Qasja e KOSTT dhe KEDS në veri është duke u vonuar

Pengimi i KOSTT për të filluar operimin si OST i pavarur, përkatësisht si zonë/bllok rregullativ kontrollues është duke paraqitur pengesa për KOSTT që të ketë qasje në pjesën veriore të Kosovës, ashtu siç parashihet në marrëveshjen për energjinë, pika 5, e cila thotë “...KOSTT do të ri-kyçet në linjat 110kV në Valaq. Operatorët aktual në nën-stacionin Valaq do të respektojnë

udhëzimet nga qendra dispeçere e Kosovës. Si rrjedhojë, KOSTT nuk është në gjendje të mbledh të hyra nga ndarja e kapacitetit të interkoneksionit dhe rrjetit transit të energjisë elektrike të Kosovës dhe këto kosto do të vazhdojnë t'i bartin konsumatorët e energjisë elektrike në Kosovë.

Operatorët e energjisë elektrike të Serbisë operojnë në mënyrë ilegale në veri të Kosovës, edhe pse me nënshkrimin e marrëveshjes për energji Serbia ka ri-konfirmuar zotimin për shpërbërjen e tyre.

Kosova është penguar në zbatimin e zotimeve në procesin e WB6

Nëse operimi i KOSTT si OST i pavarur do të vonohet më tej, Kosova nuk do të mund t'i zbatojë zotimet për iniciativën e Ballkanit Perëndimor WB6 për krijimin e një tregu të organizuar, duke balancuar tregun rajonal dhe ndarjen rajonale të kapacitetit të interkoneksionit.

Në takimin e Sekretariatit të Energjisë më 26 prill 2016 në Vjenë sa i përket procesit të nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit WB6 për çështjet e energjisë, delegacioni i Kosovës (KOSTT, ZRRE, MZHE), bazuar në udhëzimet e dhëna nga Ministria Edita Tahiri, ka kushtëzuar nënshkrimin e MiM me përfshirjen e një kërkesë në të ku nga Serbia kërkohet të zbatohet marrëveshjen e energjisë për të mundësuar që KOSTT të fillojë operimin si OST i pavarur, përkatësisht fillimi i zbatimit të marrëveshjes KOSTT-ENTSO-E të datës 1 tetor 2015. Sekretariati i Komunitetit të Energjisë ka marrë parasysh kërkesën e Kosovës duke e përfshirë në dokumentin e përmbledhjes së takimit, edhe pse ka refuzuar që kushti i Kosovës për nënshkrim të përfshihet në MiM, gjë e cila rezultoi me mos nënshkrimin e MiM nga delegacioni i Kosovës. Delegacioni i Kosovës ka bërë publik në media pozicionin e tij.

3. LARGIMI I BARRIKADËS DHE RIVITALIZIMI I URËS SË MITROVICËS

Ende nuk është vendosur liria e lëvizjes në Urën e Mitrovicës. Largimi i barrikadës dhe rivitalizimi i Urës së Mitrovicës, i paraparë për fundin e muajit qershor 2016, nuk ka shënuar ndonjë progres të dukshëm për shkak të pengesave nga Serbia. Zyra e BE-së në Kosovë, e cila është përgjegjëse për rivitalizimin e urës, nuk ka qenë në gjendje të fillojë ndonjë punë në terren për shkak të mos-bashkëpunimit nga kryetari i komunës së Mitrovicës Veriore, i cili duket se i ndjek udhëzimet e Serbisë. Kryetari i komunës së Mitrovicës Jugore (Bahtiri) ka bashkëpunuar plotësisht, duke lëshuar lejet e nevojshme lokale urbane për punë, ndërsa kryetari i komunës së Mitrovicës Veriore (Rakic) nuk ka lëshuar akoma leje të ngjashme, duke penguar kështu fillimin e punës së rivitalizimit në urë. Në përpunje me marrëveshjen e Brukselit të datës 25 gusht 2015, procesit të rivitalizimit i janë dhënë dhjetë muaj dhe tani jemi në muajin e dhjetë dhe nuk ka asnjë progres. Serbia është duke penguar këtë çështje duke mos lejuar kryetarin e komunës së Mitrovicës Veriore të nënshkruaj Memorandumin e Mirëkuptimit me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, i cili konfirmon vijën administrative ndërmjet dy komunave të Mitrovicës, në përpunje me Ligjet e Kosovës dhe

planin e Ahtisaarit. Edhe pse kjo çështje nuk ndërlidhet me rivitalizimin e urës, Serbia është duke bërë çdo gjë për të penguar largimin e barrikadës dhe për të hapur urën për lëvizje të lirë të plotë të njerëzve dhe automjeteve sepse në aspektin politik kjo nënkupton përfundimin e skenarëve ndarës të Serbisë.

Në bazë të Marrëveshjes së Brukselit të datës 25 gusht 2015, Ura e Mitrovicës duhet të hapet për qarkullim deri në verë/jo më vonë se fundi i muajit qershor 2016. Sipas Zyrës së BE-së në Kosovë, kontraktori për rivitalizimin e Urës së Mitrovicës është përzgjedhur dhe kontrata është nënshkruar, por punimet nuk kanë filluar akoma.

Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, z. Agani, pas kërkesës së Ministres për Dialog, znj. Tahiri, ka krijuar mekanizimin e takimeve javore me dy kryetarët e komunave që nga muaji maj i këtij viti në mënyrë që të shtyjë përpara nënshkrimin e MiM; megjithatë, kryetari i komunës së Mitrovicës Veriore (Rakic) nuk është paraqitur në takim. Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, z. Maric, ka marrë pjesë në një takim dhe ka dhënë kontribut konstruktiv. Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit për konfirmimin e vijës administrative ndërmjet dy komunave duket të jetë i mundur vetëm nëpërmjet përfshirjes së BE-së dhe qeverisë së SHBA-ve.

4. FUNKSIONIMI I BRISHTË I KATËR KOMUNAVE VERIORE NË KOSOVË

Funksionimi i katër komunave veriore (Mitrovica Veriore, Zveçani, Zubin Potoku dhe Leposaviçi) të zgjedhura në zgjedhjet lokale të Kosovës në vitin 2013 vazhdon të jetë i brishtë në aspektin ligjor.

Këto komuna akoma nuk kryejnë shumicën e detyrave të tyre në përputhje me legjislacionin e Kosovës, siç kërkohet me marrëveshjen e parë të Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve. Arsytet kryesore për këto dështime janë ndërhyrjet e Serbisë në të dyja anët, së pari përmes pengimit të strukturave komunale të zgjedhura në mënyrë legale në respektimin e ligjit të Kosovës dhe përmes përkrahjes së funksionimit të strukturave ilegale paralele komunale.

Disa nga shqetësimet kryesore janë si në vijim:

1. Simbolet, vulat dhe logot nuk janë aprovuar akoma nga komunat. Herë pas here, ato përdorin vula ilegale

2. Buxheti dhe prokurimi nuk kryhen në përputhje me legjislacionin e Kosovës

3. Sektorët e arsimit dhe shëndetësisë nuk përfshihen në buxhetin e nivelit lokal që administrohet nga komunat në përputhje me ligjin e Kosovës për administratën lokale. Siç dihet, këto komuna gëzojnë kompetenca të zgjeruara në krahasim me komunat tjera në Kosovë. Në mesin e kompetencave të zgjeruara janë Universiteti i Mitrovicës Veriore dhe spitali rajonal.

4. Stafi Administrativ nuk është integruar akoma, përpos në Mitrovicën Veriore

5. Shërbimet publike lokale kryesisht ofrohen nga strukturat paralele, të cilat politikisht dhe financiarisht mbështeten nga Serbia.

6. Regjistrimi i popullsisë në katër komunat veriore të Kosovës që është planifikuar të ndodh këtë vit po kundërshtohet vazhdimisht nga Kryetarët e këtyre komunave. Qeveria e Kosovës ka miratuar Projektligjin për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në katër komunat veriore të Kosovës, që refuzuan të marrin pjesë në regjistrimin e popullsisë në vitin 2011, dhe ia ka paraqitur Kuvendit të Kosovës për miratim (më 29 prill 2016). Regjistrimi duhet të ndodh në muajin tetor 2016 dhe ky proces kërkon bashkëpunim dhe përfshirjen e kryetarëve të komunave dhe administratës komunale të komunave veriore. Një marrëveshje interne për mbajtjen e regjistrimit është arritur në një takim të mbajtur në fillim të vitit 2014 në mes të Zëvendëskryeminstres së atëhershme Edita Tahiri dhe kryetarëve të zgjedhur të këtyre komunave, me praninë e zyrës së BE-së dhe Ambasadës Amerikane në Kosovë. Kryetarët e komunave ranë dakord për regjistrimin në këmbim të rritjes së numrit të këshilltarëve komunal në Kuvendet e dy komunave, përkatësisht Zveçanit dhe Zubin Potokut (nga katër këshilltar në secilën prej tyre). Megjithatë, duke ndjekur udhëzimet negative të Serbisë, këta kryetarë të komunave janë duke refuzuar regjistrimin, prandaj është e rëndësishme përfshirja e BE-së për të zgjidhur çështjen duke pasur parasysh rëndësinë e shumëfishtë të regjistrimit në planifikimin dhe zhvillimin e komunave.

5. STRUKTURAT PARALELE TË SERBISË NË KOSOVË ENDE NUK JANË SHUAR

Serbia ka vazhduar me shkeljen e parimeve themelore të marrëveshjes së Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve mes dy shteteve. Serbia po ndërhyr në Kosovë duke i mbështetur strukturat e veta paralele komunale në pjesën veriore të Kosovës madje në disa fusha edhe pjesë tjera të Kosovës. Përmes strukturave të saj paralele, Serbia po mundohet të ndjek planet e saj famëkeqe për të ndryshuar strukturën etnike në komunat veriore. Kjo mund të shihet në ndërtimet ilegale të banimit kolektiv veçanërisht në Mitrovicën Veriore dhe, me projektin e fundit ilegal për ndërtimin e kompleksit të banimit për serbët, projektin e ashtuquajtur 'Lugina e Diellit', ndërsa shqiptarët po pengohen të kthehen dhe të ndërtojnë shtëpitë e tyre.

Marrëveshja e Brukselit e datës 19 prill 2013 përcakton krijimin e komunave ligjore në Kosovë. Serbia si nënshkruese e kësaj marrëveshjeje është dashur t'i shuaj strukturat e veta paralele në Kosovë pas inaugurimit të organeve të zgjedhura komunale në janar të vitit 2014. Përkundër kësaj, Serbia ka zgjedhur të shkel marrëveshjen e cila ka shkaktuar paradokse të funksionimit të strukturave komunale legale dhe ilegale në Kosovë sot e kësaj dite. Në përgjigje të kësaj, Kosova

ka kushtëzuar themelimin e Asociacionit me largimin e plotë dhe të verifikuar të strukturave paralele të Serbisë në Kosovë, si në nivelin komunal ashtu edhe në atë qendror.

Sipas dëshmive tona, kryetarët ilegal janë ata që marrin përkrahje politike dhe fonde nga Serbia dhe me fuqinë e tyre joligjore në masë të madhe po e minojnë punën e kryetarëve të zgjedhur në mënyrë demokratike/organeve komunale për të kryer funksionet e tyre në përputhje me ligjin e Kosovës.

Kjo mund të vërehet nga provokimi i dyfishtë i fundit, kur Qeveria e Serbisë përmes strukturave të saj paralele në Kosovë (kryetari i të ashtuquajturit organ i përkohshëm i Komunës së Zveçanit, Ivan Todosijević) paraqiti një projekt të paligjshëm për ndërtimin e kompleksit të banimit për serbët që ka për qëllim ndryshimin e strukturës etnike në veri të Kosovës, projektin e ashtuquajtur "Lugina e diellit". Këto lloj provokime kanë hasur në reagim të ashpër nga shumica e qytetarëve të Kosovës të cilat konsiderohen si vazhdimësi e planeve të regjimit të Milosheviqit për spastrimin etnik dhe kolonizimin e Kosovës.

Një rast tjetër që tregon për aktivitetet e strukturave paralele është identifikuar në fund të marsit të vitit 2016, ku Policia e Kosovës ka njoftuar se qytetarja Kosovare Serbe Vesna Dabetiq nga fshati Shalinovic në komunën e Istogut, gjersa po shkonte në punë si mësuese e gjuhës ruse në shkollën fillore "Radosh Tosic" në fshatin Videjë - Komuna e Klinës ishte kërcënuar dhe fyer nga Bozhidar Sarkoviq, i cili gjatë intervistës në stacionin e Policisë kishte deklaruar se ai ishte kryetar paralel i komunës së Klinës.

Për më tepër, më 30 janar 2016, Qeveria e Serbisë e kishte emëruar Milosh Filiçin në pozitën e kryetarit të ashtuquajturës "organi i përkohshëm komunal" i Kamenicës. Po ashtu, për anëtarë të këtij organi, Serbia kishte emëruar Nenad Stankoviçin dhe Vojilsav Noiçin. Më 15 janar 2016 Qeveria e Serbisë kishte marr vendim për të krijuar të ashtuquajturën ndërmarrje publike "Resorti për skijim Serbia" në Brezovicë. Tre ditë më vonë, komuna ilegale paralele e Vitisë lëshoi një dokument dhe ia adresoi Doganës së Kosovës.

Veprimet e tilla joligjore janë hulumtuar nga mediat e Kosovës. Në fund të vitit të kaluar, një gazetë e përditshme kosovare ka publikuar një artikull <https://koha.net/?id=27&l=90868> të titulluar "Vazhdon forcimi i strukturave paralele serbe në Kosovë." Artikulli citon qeverinë e Serbisë, deklaratën për shtyp të të ashtuquajturës 'Zyre për Kosovë' mbi emërimin e Zoran Stojkoviç si kryetar i 'Rajonit të Anamoravës' me seli në Kllokot (Komuna e Kosovës me shumicë Serbe). Deklarata thotë se Stojkoviç do të koordinon funksionimin e institucioneve të Republikës së Serbisë në rajonin e Anamoravës. (Personi i njëjtë ishte deri para disa ditësh 'Kryetar Komune' i Komunës paralele të Gjilanit).

6. ASOCIACIONI

Asociacioni i komunave me shumicë serbe në Kosovë nuk do të ketë ndonjë pushtet ekzekutiv dhe nuk do të jetë një nivel i tretë i qeverisjes, ashtu siç e përcakton Marrëveshja e Brukselit e datës 25 gusht 2015. Statuti i Asociacionit do të jetë në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin e Kosovës si dhe Vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës të datës 26 dhjetor 2015. Pajtueshmëria e Marrëveshjes për Asociacionin me Kushtetutën e Kosovës kërkohet në pikën 2 të kësaj Marrëveshje. Qeveria e Kosovës e konsideron Asociacionin si një strukturë ligjore që do të ndihmon komunat për të koordinuar më mirë çështjet lokale dhe ndihmoj integrimin e komunitetit serb në sistemin e Kosovës.

Qeveria e Kosovës rikonfirmon se krijimi i Asociacionit është i kushtëzuar me shpërbërjen e plotë të strukturave të mbetura paralele të Serbisë në Kosovë. Asociacioni nuk mund të themelohet, ndërsa vazhdohet me situatën paradoksale të funksionimit të dy lloj komunave ligjore dhe jo ligjore në Kosovë.

Parimi i rënë dakord është se procesi i hartimit të statutit të Asociacionit do të jetë i sinkronizuar me procesin e shpërbërjes së strukturave paralele të Serbisë në Kosovë.

Me datën 19 janar 2016, në takimin e thirrur nga BE-ja, ku ndër tjerash u diskutua edhe mbi çështjen e Asociacionit të komunave me shumicë Serbe, pala e Kosovës rikonfirmoi zotimin e Qeverisë së Kosovës për zbatimin e kësaj marrëveshje, bazuar në Kushtetutën e Kosovës, legjislacionin e Kosovës, Ligjin për ratifikimin e Marrëveshjes së Parë dhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës të 23 dhjetorit 2015. Pala e Kosovës deklaroi se shpërbërja e plotë e strukturave paralele të Serbisë në Kosovë dhe zbatimi i marrëveshjes për Asociacionin duhet të shkojnë paralelisht.

Të njëjtat parime po ashtu janë konfirmuar në takimin mes Kryeministrit Mustafa dhe Përfaqësueses së Lartë Mogherini që ishte zhvilluar më 27 janar 2016 në Bruksel. Pala e Kosovës e ka bërë të qartë se Asociacioni (aprovimi i statutit) nuk do të themelohet pa shpërbërjen e plotë dhe të verifikuar të strukturave paralele.

7. SHPËRBËRJA E "MBROJTJES CIVILE" DHE INTEGRIMI I ISH PERSONELIT NË INSTITUCIONET CIVILE TË KOSOVËS

Është arritur progres i mirë në shpërbërjen e strukturës ilegale, të ashtuquajturës "mbrojtje civile" dhe integrimin e ish personelit të saj në institucionet e Kosovës. Kjo pavarësisht faktit se pala serbe ende nuk i ka dorëzuar objektet që janë përdorur nga kjo strukturë. Qeveria e Kosovës ka integruar tashmë 433 persona, 105 vitin e kaluar dhe 328 kanë nënshkruar kontrata të punës me 11 janar 2016. Integrimi i 50 kandidatëve të mbetur nga fondi i kontingjencës është në fazën përfundimtare, dhe pritet të përfundojë deri në fund të qershorit. Marrëveshja ka parashikuar se personat në fondin e kontingjencës duhet të integrohen në sektorin publik brenda afatit prej tre vjetësh, por si një shenjë e vullnetit të mirë, Qeveria e Kosovës ka vendosur t'i integroj/punësoj të gjithë ata sa më shpejt që të jetë e mundur.

Lista përfundimtare e institucionit dhe numri i personelit të integruar nga ish "MC" përfshirë personat nga fondi i kontingjencës.

	Institucioni	
1.	Agjencia e Menaxhimit Emergjent	82
2.	Shërbimi Korrektues i Kosovës	27
3.	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	30
4.	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	32
5.	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	32
6.	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	8
7.	Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë	8
8.	Agjencioni Pyjor i Kosovës	20
9.	Administrata Tatimore e Kosovës	15
10.	Ministria e Shëndetësisë	22
11.	Ministria e Infrastrukturës	32
12.	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	22
13.	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	26
14.	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	14
15.	Agjencia e Shoqërisë së Informacionit	7
16.	Agjencia e Statistikave të Kosovës	10
17.	Agjencia Shtetërore e Arkivave	9
18.	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë	6
19.	Dogana e Kosovës	22
20.	Ministria e Administratës Publike	13
21.	Ministria për Komunitete dhe Kthim	17
22.	Ministria e Zhvillimit Ekonomik	18
23.	Agjencia Kadastrale e Kosovës	6

24.	Ministria e financave	5
	GJITHSEJ	483

Trajnimet

Personeli i integruar i ish 'MC' iu është nënshtruar trajnimeve. Faza e parë ishte organizuar nga OSBE-ja dhe ka filluar më 8 shkurt 2016, faza e dytë ka filluar 6 javë më pas dhe është përmbyllur nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike, dhe ka zgjatur deri në fund të muajit prill 2016.

Zyrat e institucioneve qendrore qeveritare

Qeveria e Kosovës i ka identifikuar objektet/lokalet e punës për akomodimin e institucioneve qendrore qeveritare në katër komunat veriore të Kosovës. Ministria e Administratës Publike është në proces të funksionalizimit të këtyre lokaleve, respektivisht renovimit, furnizimit dhe mirëmbajtjes së këtyre zyrave.

Lokalet e përdorura nga ish MC akoma nuk iu janë dorëzuar institucioneve të Kosovës, Serbia po e vonon këtë detyrim gati një vit. Afati i fundit sipas marrëveshjes ishte 20 korrik 2015.

Shpërbërja e MC nga Serbia

Për të kompletuar shpërbërjen e të ashtuquajturës 'mbrojtje civile' Serbia obligohet të ndërmerr rregullime ligjore për shpërbërjen e strukturës së MC në Kosovë. Serbia duhet t'i paraqet dëshmi zyrtare BE-së për shpërbërjen, menjëherë pasi Kosova të ketë zgjidhur çështjen e 50 anëtarëve të mbetur nga Fondi i Kontingjencës që pritet të përmbyllet së shpejti. Dëshmia e shpërbërjes përfshinë ndryshimin e ligjeve me qëllim të shpërbërjes së "MC" dhe dëshminë për ndërprerjen e pagave dhe çfarëdo mbështetje financiare.

8. SIGURIA – POLICIA

Në përgjithësi, zbatimi i marrëveshjes mbi policinë ka qenë i kënaqshëm. Strukturat paralele të policisë janë shpërbërë. Më 31 dhjetor 2013, 287 policë Kosovarë/Serbë janë integruar në Policinë e Kosovës dhe më 22 korrik të vitit 2013 është krijuar Drejtoria Rajonale. Drejtori Rajonal është serb i Kosovës, ndërsa Zëvendës Drejtori është shqiptar i Kosovës, i emëruar më 25 qershor të vitit 2013. Integrimi i stafit administrativ dhe shpërbërja e atij paralel është çështje ende e pazgjidhur.

9. THEMELIMI I ZYRAVE TË AGJENCISË PËR REGJISTRIM CIVIL DHE ZYRAT KOMUNALE PËR REGJISTRIM CIVIL SI DHE INTEGRIMI I STAFIT ADMINISTRATIV NË KOMUNAT VERIORE

Sipas marrëveshjes së Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve të datës 19 prill 2013, Kosova është në proces të integrimit të stafit administrativ të ish policisë prej 77 personave në sistemin e Kosovës. Prej tyre, 32 persona janë përzgjedhur dhe do të punësohen në Agjencinë për Regjistrim Civil (ARCK)/ Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) të Kosovës, dhe 45 në zyrat komunale të regjistrimit civil në katër komunat veriore. Paneli i rekrutimit të ARCK e ka përmbyllur punën e tij më datën 1 qershor 2016 dhe ka përzgjedhur 32 kandidatë që do të punësohen në zyre të ARCK e cila lëshon dokumentet shtetërore siç janë: pasaportat dhe letërnjoftimet. Ata do të fillojnë me trajnimet e organizuara nga ARCK. Në ndërkohë, Ministria e Punëve të Brendshme së bashku me komunat do t'i akomodojnë stafin e integruar në kuadër të ndërtesave komunale.

Për të përfunduar integrimin, komunat veriore do të integrojnë 45 persona, të cilët do të lëshojnë certifikata të gjendjes civile. Pas fillimit të punës nga ana e këtyre dy mekanizmave institucional në veri, do të fillojmë të lëshojmë dokumente të shtetësisë dhe të gjendjes civile të Kosovës në katër komunat veriore, të cilat për një kohë të gjatë nuk kemi mundur t'i lëshojmë për shkaqe të njohura politike. Kjo arritje si edhe të tjerat janë mundësuar në sajë të dialogut të Brukselit.

9. DREJTËSIA

Zbatimi i Marrëveshjes për Drejtësi është në proces të finalizimit. Pala e Kosovës ka punuar shumë për t'i integruar në mënyrë të suksesshme personelin e ish strukturave paralele të drejtësisë në sistemin e Kosovës. Këto struktura paralele de facto kanë ndaluar operimin, ndërsa de jure shpërbërja e tyre nga Serbia duhet të ndodh menjëherë pas integrimit dhe fillimit të punës së sistemit të drejtësisë së Kosovës të në pjesën veriore të vendit.

Zbatimi i marrëveshjes për drejtësi mundëson krijimin e sistemit unik të drejtësisë së Kosovës në pjesën veriore të Kosovës, ku një gjykatë themelore për shtatë komunat dhe një zyre prokuroriale do të fillojnë së shpejti funksionimin, në pajtim me legjislacionin e Kosovës, siç parashihet në marrëveshjen e Brukselit të datës 9 shkurt 2015. Kosova po e konsolidon sistemin e saj unik të drejtësisë në pjesën veriore, e cila ka munguar për shumë vite.

Serbia ende nuk ka shpërbërë ligjërisht strukturat e saja paralele gjyqësore në Kosovë, që duhet të ndodh menjëherë pasi të fillojnë punën strukturat ligjore të Kosovës. Shpërbërja kërkon ndryshime ligjore në Ligjin e Serbisë nr. 116/2008 mbi Selitë dhe Juridiksionet Territoriale të Gjykatave dhe Zyra të Prokurorëve. Afati i fundit ishte deri më 31 dhjetor 2013 për zhbërje dhe integrim. Serbia ende nuk ka shfuqizuar kontratat e punës për personelin gjyqësor të angazhuar në strukturat paralele gjyqësore, si dhe nuk ka ndaluar pagat e tyre. Këto struktura, de-facto, kanë ndaluar operimin që nga viti 2013 sipas marrëveshjes. Serbia ka qenë

bashkëpunuese, de facto, në mbylljen e funksionimit të strukturave paralele, duke pasur parasysh se gjykatat paralele serbe në Kosovë nuk janë më duke pranuar raste të reja penale dhe që nga 1 shtatori 2013 ato kanë ndaluar gjykimin e atyre rasteve.

Progresi në zbatim përfshin pikat në vijim:

Integrimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve Serb është zhvilluar në dy faza.

Faza e parë e integrimit - rekrutimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve

Në fazën e parë të integrimit (e filluar në mars të vitit 2015) ishin përzgjedhur 34 gjyqtarë dhe 9 prokurorë, të cilët i kanë përmbushur kriteret, për 48 pozitat për gjyqtarë dhe 15 pozitat për prokuror (sipas marrëveshjes dhe shpalljes zyrtare).

Faza e dytë e integrimit - rekrutimi i numrit të mbetur të gjyqtarëve dhe prokurorëve

Procesi i rekrutimit për pozitat që kanë mbetur të paplotësuara nga faza e parë për 14 gjyqtarët dhe 6 prokurorët është shpallur më 29 mars 2016. Integrimi do të përfundojë më 30 qershor 2016.

Më 1 mars 2016, pala kosovare i ka dorëzuar BE-së njoftimet përfundimtare të konkursit për vende pune për prokurorë, gjyqtarë dhe staf mbështetës dhe në të njëjtën datë pala kosovare u zotua se paneli në parim do të vendos në përputhje me marrëveshjen e datës 9 shkurt 2015 dhe praktikave të zbatuara në mars 2015, në fazën e parë të përzgjedhjes për integrim, kur është fjala për kushtet e përgjithshme për gjykatës dhe prokurorë që aplikojnë për pozita. Shpallja e vendeve tjera të lira të punës është përgatitur në bazë të Ligjit të ndryshuar për Gjykatat dhe Ligjin për Prokurorin e Shtetit (të vitit 2015).

Procesi i rekrutimit për 149 punëtorë si staf administrativ

Shpalljet e para për integrimin e stafit mbështetës prej 149 pjesëtarëve, në përputhje me Marrëveshjen e Brukselit për Drejtësi të datës 9 shkurt 2015 (115 staf mbështetës për gjyqtarë dhe 34 staf mbështetës për prokurorët) ishte hapur nga data 29 mars 2016 deri më 29 prill 2016.

Dokumentet e shtetësisë - bazuar në praktikat e punësimit gjatë procesit të rekrutimit të parë nga ana e KGJK-së dhe KPK-së, minimumi që kandidatët duhet të paraqesin para panelit të rekrutimit është aplikimi për letërnjoftimin e Kosovës. Gjithashtu letërnjoftimet do të kopjohen dhe do t'i dorëzohen KGJK-së, pas rekrutimit, por para emërimit final nga Presidenti i Republikës.

Procesi i rekrutimit për gjyqtarët dhe prokurorët dhe stafin administrativ për Gjykatat dhe Prokuroritë ka filluar më 25 maj.

Interesimi i kandidatëve që konkurruan në konkurset për punësim (149 pozita për stafin mbështetës, 17 pozita për prokurorë, 14 pozita për gjyqtarë ishte mjaft i madhe. P.sh. rreth 3.000 kandidatë konkurruan për staf mbështetës. Kjo tregon trendet pozitive të ri-integrimit dhe gatishmërinë e serbëve të Kosovës për t'u integruar në sistemin e Kosovës që padyshim duhet t'i atribuohet ndikimit të dialogut të Brukselit.

Më 16 maj të vitit 2016, BE-ja ka prezantuar listën e ish-personelit që do të integrohet në sistemin e drejtësisë në Kosovë, një listë e cila është në procesin e verifikimit të sigurisë nga autoritetet kompetente të Kosovës.

Në pajtim me ligjin e Kosovës, kandidatët e miratuar nga KGJK-ja dhe KPK-së do t'i dërgohen Presidentit të Kosovës për emërim si gjyqtarë dhe prokurorë. Të gjithë të pranuarit duhet të kenë letërnjoftimin e Republikës së Kosovës si dëshmi e shtetësisë së Kosovës. Së fundi, kandidatët e emëruar do të bëjnë betimin dhe nënshkruajnë deklaratën e besnikërisë në praninë e Presidentit të Kosovës.

Rekrutimi i personelit administrativ

a. Ministria për Dialog Edita Tahiri nxori vendimin për emërimin e panelit përgjegjës për përzgjedhjen e kandidatëve të personelit administrativ për qëllime integrimi në gjykatat dhe prokuroritë e Republikës së Kosovës dhe Letrën e Udhëzimeve në lidhje me procesin e integritetit të personelit administrativ nëpër gjykatat dhe prokuroritë e Republikës së Kosovës në bazë të Marrëveshjes së Brukselit për Drejtësinë, të arritur më 9 shkurt 2015, ku ky vendim është në përputhshmëri të plotë me ligjet e Republikës së Kosovës dhe u nënshkrua nga Ministria për Dialog më 24 maj 2016¹.

b. Paneli për gjykatësit u krijua më 6 prill 2016 nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

c. Paneli për prokurorët u krijua më 22 prill 2016 nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

d. Provimi i jurisprudencës

Disa prej kandidatëve do t'i nënshtrohen provimit të jurisprudencës në përputhje me legjislacionin e Kosovës dhe Marrëveshjen e Brukselit. Ai vlen për kandidatët që e kanë kryer fakultetin në Serbi (gjithsej 6 raste).

¹ Bazuar në Marrëveshjen e parë të parimeve mbi normalizimin e marrëdhënieve të datës 19 prill 2013, përkatësisht në Ligjin nr. 04/L-199 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Parë Ndërkombëtare të Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, si dhe në Planin e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës më 27 qershor 2013, si dhe bazuar në Marrëveshjen e Brukselit për Drejtësinë të datës 9 shkurt 2015, në përputhje me Ligjin nr. 05/L-032 mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-199 për Gjykatat dhe Ligjin nr. 05/L-034 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit dhe në bazë të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, neni 3, pika 6.

Buxheti për qiranë dhe renovimin e objektit të prokurorisë

Çështja e buxhetit për qiranë e objektit të prokurorisë është zgjidhur. Pas dy takimeve të Ministres për Dialog me Ministrin e Financave dhe kërkesës zyrtare të datës 29 prill 2016 nga Kreu i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) drejtuar Ministrisë së Financave, është aprovuar buxheti për qiranë dhe renovimin e objektit të prokurorisë në Mitrovicë (vendi: Lagja e Boshnjakëve). Më 20 maj 2016, Qeveria e Kosovës e aprovoi buxhetin për Prokurorinë e Mitrovicës. Këshilli Prokurorial i Kosovës po punon për përsheptimin e çështjes së kontratës mbi qiranë dhe punët tjera për ta bërë atë funksionale.

Objekti i Gjykatës Themelore

Gjykata Themelore do të vendoset në dy ndërtesa: në ndërtesën ekzistuese të gjykatës themelore në veri dhe në ndërtesën e ish-Jugobankës në Mitrovicën jugore.

Objektet për dy degët e gjykatës themelore në Leposaviq janë të gatshme për shfrytëzim, megjithëse për momentin ndërtesa vazhdon të jetë e zënë nga gjykatësit serbë që janë në pritje të integritimit. Ndërtesa në Zubin Potok duhet të rinovohet. KGJK-ja do të fillojë procesin e ritenderimit. Planet janë në përgatitje e sipër.

11. ZYRAT NDËRLIDHËSE (ZN) DHE VIZITAT ZYRTARE BILATERALE

Takimet e nivelit të lartë

Nuk është bërë ndonjë përparim në kuadër të takimeve zyrtare të Zyrtares Ndërlidhëse të Kosovës me Ministrat e Qeverisë së Serbisë. Vetëm një takim i tillë u mbajt vitin e kaluar pas këmbënguljes sonë në takimet e dialogut të Brukselit. Në anën tjetër, Zyrtari Ndërlidhës i Serbisë është pranuar në nivelin e lartë nga zyrtarët e Qeverisë së Kosovës.

Personeli dhe objektet

Marrëveshja për staf shtesë dhe ambiente më të mëdha të punës në të dyja zyrat ndërlidhëse ende nuk është zbatuar. Jo-zyrtarisht kemi mësuar që pala serbe është tërhequr nga kjo marrëveshje e arritur në shtator të vitit 2015.

Simbolet zyrtare (në ballina të letrave dhe në vula)

Ende nuk ka marrëveshje në lidhje me ballinat e letrave dhe vulat për përdorim zyrtar nga ZN-të. Ekziston opinioni i përbashkët që formulimi dhe dukja e ballinave të letrave do të jetë e njëjtë si për vulat.

Vizitat zyrtare

Marrëveshja për vizitat zyrtare, sipas së cilës ZN-të menaxhojnë vizitat, ndryshe nga ç'ndodhte në të kaluarën kur delegacionet e BE-së në të dy shtetet e ofronin këtë shërbim, po zbatohet goxha mirë. Në 12 muajt e fundit janë dorëzuar mbi 100 kërkesa nga zyrtarët serbë dhe vetëm disa prej tyre u refuzuan, kryesisht për shkak të mosrespektimit të kushteve të lejes. Marrëveshja për vizitat zyrtare ndër të tjera parashih respektimin e frymës së Marrëveshjes për Normalizimin e Marrëdhënieve mes dy shteteve. Gjatë kësaj periudhe raportuese pala serbe i ka bërë disa shkelje.

Zyrtarë nga Serbia sërish kanë hyrë pa leje në Republikën e Kosovës përmes pikë-kalimeve ilegale. Më 15 prill 2015, Marko Djuric i shoqëruar nga Dragan Vladislavjevic hynë në Kosovë duke kaluar përmes pikë-kalimeve ilegale.

12. DOGANA / TREGTIA E LIRË

Tregtia e lirë ndërmjet dy shteteve u mundësua falë njohjes reciproke të vulave doganore më 2011 dhe zbatimi është në nivel të kënaqshëm. Ende ka pengesa si pasojë e strukturave paralele të Serbisë dhe përdorimit të kohëpaskohshëm të vulave doganore paralele nga ana e institucioneve doganore të Serbisë. Raste të këtij problemi në pikë-kalimet Merdare dhe Dheu i Bardhë regjistrohen gati çdo ditë.

Serbia duhet ta respektojë marrëveshjen dhe t'i shpërbëj strukturat dhe vulat e saja paralele doganore. Organogrami i Administratës Doganore të Serbisë (zyrat doganore) ende e përfshinë Prishtinën si zyrë të saj doganore. Linku i mëposhtëm jep të dhëna shpesh rreth strukturës organizative: www.carina.rs/lat/ONama/organizacija/Stranice/Osnovna.aspx. Vulat ilegale përdorin mbishkrimin "Dega Doganore në Prishtinë", ku kjo e fundit është nën Degën Doganore të Nishit në Serbi.

Kjo tregon që Serbia, edhe pas pesë vjetësh, nuk po e respekton plotësisht Marrëveshjen për njohjen e ndërsjellë të vulave doganore, të arritur më 2 shtator 2011 dhe që, për më tepër, po i shkel rregullat e CEFTA-së, në kuadër të të cilave palët janë pajtuar që të përdorin vulat e konfirmuara për të gjithë anëtarët e CEFTA-së.

Pala e Kosovës vazhdimisht e ka ngritur këtë çështje në kuadër të takimeve të grupit punues për Menaxhimin e integruar të kufirit, duke kërkuar nga Serbia që të respektojë Marrëveshjen për vulat doganore të 2011-ës. Pala serbe verbalisht ka premtuar ta bëjë këtë, mirëpo nuk e ka bërë në praktikë.

Reciprociteti mbi "tabelat e përkohshme të regjistrimit"

Nuk është arritur progres në lidhje me heqjen e masave të përkohshme të zbatuara në mënyrë të njëanshme nga Serbia ("tabelat provuese" për tabelat e regjistrimit RKS dhe dokumentet e hyrjes-daljes). Në Bruksel, dy kryeministrat ishin marrë vesh në janar të vitit 2016 që kjo çështje të zgjidhet në qershor mbi parimin e reciprocitetit. Në katër takimet e mbajtura vitin e kaluar më 30 shtator, 9 tetor dhe 27 tetor dhe këtë vit në janar, Kosova ka insistuar që Serbia duhet të ndërpresë zbatimin e masave të përkohshme në mënyrë të njëanshme dhe kërcënoi me vënien e masave reciproke. Ajo deklaroi që nëse Serbia nuk i heq tabelat "provuese" për tabelat e regjistrimit 'RKS' të automjeteve të Kosovës, atëherë Kosova do të përdorte të drejtën e garantuar nga Marrëveshja për të zbatuar masa reciproke për automjetet që vinë nga Serbia. Pas premtimit të BE-së për zgjidhjen e kësaj çështje, Kosova pranoi të shtynte zbatimin e masave të tilla, ndërsa tash së fundmi e ka njoftuar BE-në që afati për zgjidhjen e kësaj çështje po kalon.

Qytetarëve të vendeve të treta nuk u lejohej të hynë në Serbi nga Kosova

Serbia po vazhdon të mos lejojë kalimin e qytetarëve të vendeve të treta nga Kosova në Serbi. Në takimin e fundit të GP të MIK të mbajtur më 7 dhe 8 mars 2016, ne e ngritëm sërish këtë çështje, mirëpo pala serbe nuk dëshiron të arrijë marrëveshje për këtë çështje. Kapitulli 35 i BE-së i bën thirrje Serbisë që ta zgjidhë këtë çështje.

Tabelat ilegale të regjistrimit

Serbia ende lëshon tabela ilegale të regjistrimit në komunat veriore të Kosovës, duke shkelur kështu Marrëveshjen për Lirinë e Lëvizjes të 2011-ës, e cila parasheh qartë që të gjithë banorët e Kosovës duhet t'i regjistrojnë veturat e tyre me tabela të regjistrimit RKS ose KS. Kosova e ka bërë të qartë që është duke hartuar planin për zgjidhjen e kësaj çështjeje, krahas problemit të automjeteve të paregjistruara në Kosovë

Letërnjoftimet ilegale

Është me rëndësi të përmendet që mbi 90.000 serbë të Kosovës janë pajisur me letërnjoftime të Republikës së Kosovës, gjë që tregon trendin në rritje të reintegrimit të tyre në sistemin e Kosovës. Mirëpo, ende ka individë që përdorin letërnjoftimet ilegale të lëshuar nga strukturat paralele. Në kuadër të grupit punues për MIK, Kosova e ngriti sërish këtë çështje më 7 dhe 8 mars 2016 në Bruksel dhe u kuptua pozitivisht nga ana e BE-së. BE-ja ka premtuar që do të ofroj propozim që me një proces tranzicioni ti jepet fund letërnjoftimeve ilegale.

14. MIK – NDËRTIMI I OBJEKTEVE TË PËRHERSHME

Zbatimi i marrëveshjes për IBM është i shkëlqyeshëm, duke marrë parasysh bashkëpunimin tejet konstruktiv ndërmjet autoriteteve kufitare të të dyja shteteve.

Faza e dytë e zbatimit që përfshinë ndërtimin e objekteve të përhershme në të gjashtë pikë-kalimet kufitare është duke shkuar mirë. Pala e Kosovës do t'i ndërtoj objektet në tre pikë-kalime kufitare: Merdare, Bërnjak dhe Mutivodë, ndërsa ajo e Serbisë në tre pikë-kalimet e tjera: Jarinje, Dheu i Bardhë dhe Muçibabë.

Dizajni i objekteve të përhershme është nënshkruar nga të tre palët: Kosova, Serbia dhe BE-ja në shtator 2014. Dizajni është bërë nga kompania e kontraktuar nga BE-ja SAFEGE, në konsultim të ngushtë me secilën prej palëve.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, UNOPS (partneri implementues i kontraktuar nga BE-ja) është duke bërë dizajnin e hollësishëm në konsultim me secilën prej palëve. Kosova është treguar tejet aktive në përmbushjen e të detyrave të saj, si dhe ka kryer shpronësimin e tokave në zonat e MIK. Kosova po ashtu ka marrë një vendim të rëndësishëm mbi pozitën e ndërtesave administrative, pas konsultimeve me autoritetet përkatëse të Policisë, Doganës, ndërmjetësuesve të BE-së dhe ekipin e UNOPS-it. Në fazën e ardhshme do të diskutohet funksionalizimi i objekteve derisa po i afrohem finalizimit të projektit/ dizajnit të hollësishëm për tre pikë-kalimet kufitare. Punimet e ndërtimit të pikë-kalimit në Merdare planifikohet të nisnin në fillim të gushtit.

Megjithatë, bazuar në raportimin në takimin e fundit të grupit punues të MIK (7-8 mars 2016), pala serbe ende nuk ka bërë ndonjë përparim të rëndësishëm. Përfaqësuesi i Drejtorisë së Përgjithshme për Politika të Fqinjësisë dhe Negociata të Zgjerimit në Komisionin Evropian në takimin e fundit të grupit punues të MIK kërkoi progres përmbajtësor në lidhje me projektet përkatëse për pikëkalimet e përhershme kufitare MIK.

Pikë-kalimet e reja kufitare

Deri në shtator të vitit 2016 do të hapen dy pikë-kalime të reja kufitare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, njëra në vendin e quajtur Kapia dhe tjetra në vendin e quajtur Izvor, që do të shkurtojnë distancën e udhëtimit për qytetarët. Në takimin e fundit të GP për MIK të mbajtur më 7-8 mars 2016, të dyja palët raportuan progresin e arritur në zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Në bazë të dinamikës, palët konfirmuan që pikë-kalimet përkatëse kufitare nën përgjegjësinë e tyre do të jenë funksionale deri në shtator të vitit 2016

SEED

Që prej 2011-ës, pala kosovare ka qenë shumë aktive dhe serioze në themelimin e mekanizmave me qëllim të shkëmbimit të informatave me Serbinë në lidhje me funksionimin më të mirë të MIK. Që nga atëherë, i kemi ndërmarrë të gjitha masat për të filluar shkëmbimin e informatave përmes iniciativës rajonale të BE-së për Shkëmbimin Sistemik Elektronik të të Dhënave (SEED).

Në anën tjetër, pala serbe ka vonuar zbatimin e SEED ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për më tepër se një vit.

Që nga nëntori i vitit 2015, është shënuar mjaft progres në lidhje me shkëmbimin e plotë elektronik të të dhënave ndërmjet autoriteteve doganore të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë. Kjo marrëveshje është planifikuar të zbatohet qysh nga 2013-ta, mirëpo Serbia e ka vonuar zbatimin e saj. Bashkëpunimi në këtë fushë siguron kontrollimin më të mirë të eksportit dhe importit të mallrave në mes të dy shteteve. Në periudhën gjashtë mujore, Dogana e Kosovës ka ofruar 126,023 të dhëna përmes SEED-it, ndërsa Dogana e Serbisë rreth gjysmën e këtij numri, 119,302 të dhëna.

15. KADASTRI

Marrëveshja për kadastrin e datës 2 shtator 2011 parasheh angazhime për të dyja palët. Marrëveshja obligon kthimin në Kosovë të regjistrave të skanuar të dokumenteve origjinale kadastrale që ishin marrë nga Serbia gjatë kohës së luftës, para vitit 1999. Dokumentet e skanuara kadastrale do të kthehen në Kosovë përmes BE-së/PSBE.

Përfundimisht, shtatëmbëdhjetë vjet pas përfundimit të luftës së vitit 1999, Kosova do të marrë dokumentet kadastrale të marra dhunshëm nga Serbia. Kjo do t'i mundësojë të krahasojë dhe verifikojë dokumentet e skanuara të periudhës para vitit 1999 me regjistrat e rikonstruktuar kadastral të Kosovës, duke ndihmuar kështu në konsolidimin e sistemit kadastral shtetëror.

Në këtë drejtim, pala e Kosovës ka miratuar ligjin për themelimin e një agjencie teknike, të Agjencisë Kosovare për Krahasimin dhe Verifikimin e Pronave (AKKVP) më 8 qershor 2016. Roli i AKKVP-së do të jetë të identifikojë boshllëqet/diskrepancat ndërmjet dokumenteve të kthyera dhe të dhënave kadastrale të Kosovës, të cilat pastaj do të trajtohen nga mekanizmi vlerësues i Agjencisë, ndërsa vendimi përfundimtar do të merret nga Gjykata Supreme e Kosovës.

Pala serbe ka shënuar progres në skanimin e dokumenteve kadastrale që do t'i kthehen Kosovës.

Gjersa procesi i zbatimit po ec përpara nga të dyja palët, BE-ja në konsultim me palët po themelon Grupin Trepalësh të Implementimit (GTI) për të monitoruar zbatimin e marrëveshjes me fokus të veçantë në boshllëqet e identifikuar në dokumente.

Zbatimi i marrëveshjes është vonuar nga ana e Kosovës, për shkak të vonesave në miratimin Ligjit për themelimin e Agjencisë Teknike (KPCVA), e cila është bërë më në fund më 8 qershor 2016.

16.MBLEDHJA E TË HYRAVE DOGANORE NË DY PIKË-KALIMET KUFITARE TË VERIUT JARINJE DHE BËRNJAK

Marrëveshja për mbledhjen e të hyrave doganore e arritur në janar të vitit 2013 në Bruksel parasheh mbledhjen e të hyrave doganore nga autoritetet e Kosovës në dy pikë-kalimet kufitare të veriut Jarinje dhe Bërnjak, e cila ka qenë e bllokuar për shumë vite nga pala serbe. Zbatimi i kësaj marrëveshjeje është duke shkuar shumë mirë dhe gjatë kësaj periudhe raportuese nuk është identifikuar ndonjë pengesë. Një pjesë e të hyrave doganore të mbledhura shkon në Fondin Zhvillimor, i themeluar nga autoritetet e Kosovës, i cili përfshin të hyrat doganore të mbledhura nga kompanitë që operojnë në katër komunat veriore dhe nga mallrat e destinuar për qytetarët e këtyre komunave.

17.FONDI ZHVILLIMOR

Që prej themelimit të tij më 2013, Fondi Zhvillimor i Kosovës ka pranuar 8.3 milionë euro nga pjesa e taksave të mbledhura në Jarinje dhe Bërnjak, në përputhje me Marrëveshjen mbi Mbledhjen e të Hyrave Doganore të vitit 2013.

Bordi Drejtues i Fondit Zhvillimor tashmë i ka ndarë 6.6 milionë euro për projektet zhvillimore të komunave të veriut. Në bazë të projekteve praktike të paraqitura nga ato komuna, Bordi Drejtues do të vazhdojë ndarjen e fondeve.

18.BASHKËPUNIMI RAJONAL

Gjatë kësaj periudhe është shënuar një përparim shumë i mirë në lidhje me anëtarësimin e Kosovës në organizata të rëndësishme ndërkombëtare dhe rajonale. Përprojekjet e Serbisë për të penguar anëtarësimin e Kosovës në këto organizata kanë qenë të vazhdueshme, duke shkelur Marrëveshjen e Brukselit të vitit 2012, por për fat të mirë Serbia kryesisht dështoi.

Një përparim qenësor shënon nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës dhe BE-së më 27 tetor 2015 dhe hyrja e saj në fuqi më 1 prill 2016.

Sporti i Kosovës është ndërkombëtarizuar plotësisht. Kosova u bë anëtarja e 55-të e Bashkimit të Shoqatave Evropiane të Futbollit (UEFA) më 3 maj 2016 dhe anëtare e Federatës Botërore të Futbollit (FIFA) më 13 maj 2016, ndërsa më herët Kosova ishte anëtarësuar edhe në Komitetin Olimpik Ndërkombëtar. Federata Skitare e Kosovës (FSK) është pranuar në Federatën Botërore të Skijimit (FIS) si anëtare me të drejta të barabarta me të gjitha vendet anëtare më 13 qershor 2015.

Kosova zyrtarisht u bë anëtarja e 121-të me të drejta të plota e Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit me qendër në Holandë më 14 qershor 2016, përkundër përpjekjeve të Serbisë për ta bllokuar procesin që nga janari 2016.

Po ashtu, Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare të Kosovës (ARKEP) u bë anëtar i asociuar i Institutit Evropian të Standardeve të Telekomunikacionit më 19 prill 2016. Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë u bë anëtari i 28-të i Shoqatës së Ombudsmanëve Mesdhetarë më 17 prill 2016. Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës është pranuar në Federatën Evropiane të Gazetarëve më 11 mars 2016. Gjithashtu, Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) është anëtare e EUROSTAT-it që nga viti 2013, ndërsa nga 3 shkurti 2016 flamuri i Kosovës tashmë është vendosur në faqen zyrtare të EUROSTAT-it.

Delegacionet e nivelit më të lartë shtetëror të Kosovës kanë marrë pjesë si të barabartë me shtetet e tjera në samite dhe takime të ndryshme të mëdha rajonale, duke përfshirë: Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, mori pjesë në Samitin e Procesit të Bashkëpunimit në Evropën Juglindore (SEECP) më 1 qershor 2016 në Sofje, Bullgari; Kosova mori pjesë në takimin e Bordit të Strategjisë 2020 të Evropës Juglindore në Pravets, Bullgari më 30 të vitit 2016; Kosova ka marrë pjesë në të gjitha takimet e “Western Balkans Six”, duke përfshirë Takimin Ministror të organizuar nga Komisioni Evropian dhe Ministria e Jashtme e Francës në Paris më 25 maj 2016, ku u valëvitën edhe flamujt e Kosovës dhe të Serbisë. Kosova do të përfaqësohet në nivelin më të lartë shtetëror në takimin e “Western Balkans Six” në Paris më 4 korrik 2016. Kosova për herë të parë u ftua zyrtarisht në takimin e Autoriteteve për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Evropës Qendrore dhe Lindore më 11 dhe 12 maj 2016 në Sarajevë, Bosnjë. Ministrja për Dialog Edita Tahiri më 2 shkurt 2016 mori pjesë në Samitin Ministror të Organizatës së Procesit të Bashkëpunimit në Evropën Juglindore (SEECP).

Dëshmi të shkeljeve të marrëveshjes nga Serbia

Serbia ka vazhduar pengesat e saj ndaj Kosovës, në kundërshtim me Marrëveshjen e vitit 2012 për bashkëpunim rajonal. Fushata agresive e Serbisë kundër Kosovës, veçanërisht në rastin e UNESCO-së, FIFA-së dhe UEFA-së tregoi se Serbia u përpoq të përhumtë luftën e saj gjenocidale kundër Kosovës, duke u përpjekur ta stigmatizonte Kosovën në mënyra më të këqija, thjesht duke harruar se historia e luftërave agresive të Serbisë në rajon nuk mund të ndryshohet. Po ashtu, më 19 maj 2016 Federata Serbe e Futbollit dorëzoi padi në Gjykatën Ndërkombëtare të Sportit kundër pranimit të Kosovës në UEFA; Serbia anuloi pjesëmarrjen e saj në Konferencën e OSBE-së për

Bashkëpunim Ekonomik për shkak të pjesëmarrjes së Kosovës më 18 maj 2016; diplomacia serbe e bllokoj anëtarësimin e Kosovës në Organizatën Ndërkombëtare të Verës së Rrushit më 19 prill 2016; Serbia po krijon pengesa për aderimin e Kosovës në Konventën për Heqjen e Kërkesës për Legalizimin e Dokumenteve Zyrtare të Huaja dhe në Gjykatën e Arbitrazhit; në takimin e CEFTA-së më 1 mars 2016, në kundërshtim me marrëveshjen, Serbia kërkoi edhe një herë që UNMIK-u të nënshkruajë në emër të Kosovës.

19. DIPLOMAT

Më 19 janar 2016, u arrit marrëveshja e re për njohjen reciproke të diplomave në mes të Kosovës dhe Serbisë, me lehtësimin e BE-së, sepse marrëveshja e vitit 2011 kishte dështuar për shkak të faktit se Serbia refuzoi për ta zbatuar atë. Për më shumë se pesë vjet, aplikimet e kandidatëve për të vërtetuar diplomat e tyre janë vënë në pritje, së bashku me të ardhmen e tyre në arsim apo punësim. Marrëveshja e re e vitit 2016 për diplomat është bazuar në atë të vitit 2011, megjithëse e zgjeruar për të përfshirë njohjen e të gjitha diplomave nga shkolla fillore e deri ato të doktoraturës.

Në fakt, marrëveshja e re u arrit më 29 shtator 2015, por në vend se të fillojë me zbatimin, Serbia e ka kontestuar menjëherë atë. Me komente shtesë të tekstit të marrëveshjes së arritur rishtazi, Serbia u përpoq të imponon formulime që do të dëmtonin juridiksionin e Republikës së Kosovës, por pala kosovare i ka hedhur poshtë kategorikisht ndryshimet e propozuara. Serbia ka tërhequr më pas pretendimet e saj, gjë kjo e cila bëri të mundur që më 19 janar 2016 të rikonfirmohet marrëveshja e arritur më 29 shtator 2015.

Plani i zbatimit u zhvillua në ndërkohë, në disa takime të mbajtura në Bruksel dhe më 4 prill 2016 ka filluar zbatimi. Për të shmangur çdo keqinterpretim të marrëveshjes, duke pasur parasysh se historia e negociatave ishte mjaft konfuze - me arritjen, kontestimin dhe rikonfirmimin e marrëveshjen - BE-ja vendosi të publikojë vet zyrtarisht planin e zbatimit, në bazë të kërkesës së Kryenegociatores së Kosovës Edita Tahiri. Plani i zbatimit i njohur si Udhëzuesi i BE-së për njohjen reciproke të Diplomave bazuar në marrëveshjen fillestare nga viti 2011, mund të gjendet në http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/EU_Guidance.pdf. Kandidatët e interesuar kërkohet ti drejtohen ministrisë përkatëse të arsimit të secilit shtet në mënyrë që të paraqesin aplikimet e tyre.

Njësoj si me marrëveshjen e vitit 2011, diplomat fillimisht do të certifikohen nga një organizatë ndërkombëtare, e zgjedhur nga BE. Pas këtij certifikimi, aplikimi për njohje mund të dorëzohet në institucionet përkatëse të secilit shtet. Njohja do të ndahet në njohjen profesionale dhe atë akademike. Njohja profesionale do të kryhet nga organet përkatëse relevante qeveritare, në një periudhë maksimum prej 90 ditë pas pranimit të aplikimit dhe me një tarifë të barabartë me 50 euro ose shumë ekuivalente. Njohja profesionale do të konsiderohet si e mjaftueshme për mundësitë e punësimit, përfshirë edhe në organet qeveritare.

Njohja akademike do të jetë e nevojshme vetëm për vazhdimin e studimeve. Procedurat do të varen nga institucioni individual i arsimit të lartë dhe do të kenë një afat kohor të përgjithshëm prej pesë muajsh.

Të gjitha diplomat e certifikuar deri më tani nga EUA (Asociacioni i Universiteteve Evropiane) do të njihen nga palët. Diplomat e certifikuar paraprakisht nga EUA mund të dorëzohen drejtpërdrejt për njohje. Palët do të procesojnë këto duke filluar nga 4 prill 2016. Të gjitha njohjet e mëhershme të diplomave do të trajtohen si të vlefshme.

Për më tepër, palët ranë dakord për të zgjeruar fushëveprimin e marrëveshjes së vitit 2011, për të përfshirë nivelet e arsimit si në vijim: Arsimin e Lartë (Bachelor, Master dhe Doktoraturë) dhe Arsimin Para-universitar (fillor, të mesëm, arsimin profesional dhe të nivelit të pestë të kualifikimit sipas Kornizës Evropiane të Kualifikimeve).

Marrëveshja për diploma është e vlefshme vetëm për diplomat e fituara nga universitete të akredituara në vendet përkatëse, Kosovës dhe Serbisë, për të cilat palët kanë shkëmbyer listën e institucioneve të akredituara të arsimit të lartë, gjatë muajit mars të vitit 2016. Kosova e ka bërë të qartë se universitetet që operojnë në mënyrë të paligjshme në Kosovë, të cilët janë të përfshirë në listën e universiteteve të akredituara në Serbi, janë të pavlefshëm. Për diplomat e Universitetit të Mitrovicës, Qeveria e Kosovës ka krijuar një mekanizëm ligjor të njohjes së përkohshme për të ndihmuar reintegrimin e komunitetit serb në sistemin e Kosovës.

Bashkimi Evropian do të vazhdojë të mbështesë procesin duke financuar një projekt që do të lehtësojë implementimin e marrëveshjes. Në lidhje me këtë, BE-ja është në proces të identifikimit të partnerëve zbatues (për qëllime të certifikimit dhe administrimit). BE-ja ka hapur thirrjen për ofertë më 25 prill 2016 në kohëzgjatje prej 30 ditësh, pas së cilës do të përfundohet përzgjedhja e partnerëve implementues.

BE-ja ka themeluar një grup trepalësh implementues nga fundi i shkurtit 2016, për të monitoruar zbatimin e marrëveshjes.

20. SIGURIMI I AUTOMJETEVE

Zbatimi i marrëveshjes ka qenë i kënaqshëm. Ky zbatim filloi më 12 gusht 2015 pas më shumë se tre vjet negociatash. Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) është në procesin e identifikimit të Korrespondentit.

Kosova konsideron se me një Byro Kosovare të Sigurimit (BKS) që bashkëpunon në këtë marrëveshje fqinjësore në frymën Evropiane, do të përparojë drejt anëtarësimit në Kartonin e Gjelbër. Këshilli Ndërkombëtar i Byrove (COB) i cili ishte lehtësues i kësaj marrëveshje së

bashku me BE-në duhet të sigurojë pranimin e Kosovës në Kartonin e Gjelbër, ndërsa në ndërkohë ajo duhet të hapë pikat e shitjes së kartonëve të gjelbër Evropian në Kosovë.

21. CERTIFIKATAT E PRODUKTEVE FARMACEUTIKE (CPF)

Është arritur progres i mirë në drejtim të zbatimit të Marrëveshjes për njohjen reciproke të Certifikatave të Produkteve Farmaceutike (CPP).

Nga janari deri në maj 2016, autoritetet e Kosovës kanë lëshuar 26 Certifikata të Autorizimit të Marketingut për kompaninë Hemofarm AD nga Serbia. Autoritetet e Kosovës i marrin në konsideratë vetëm aplikimet që janë në pajtim me Ligjin e Kosovës, siç është paraparë me Marrëveshjen e Brukselit për këtë çështje.

Në procedurë të kontrollimit / vlerësimit të kërkesave (aplikacioneve) janë rreth 34 aplikacione për produkte farmaceutike (9 produkte të kompanisë farmaceutike Hemofarm AD, Serbi dhe 20 produkte të kompanisë Galenika a.d, Serbi).

Çështjet e pazgjidhura

Çështja që mbetet e pazgjidhur është licencimi për 19 kompanitë farmaceutike nga komunat veriore. Ky proces është dashur të përfundojë deri më 31 maj 2015, por megjithatë, vetëm 8 prej këtyre kompanive kanë aplikuar dhe janë licencuar gjatë vitit 2015 dhe një tjetër gjatë vitit 2016. Agjencia e Kosovës për Produkte Medicinale, i cili është autoriteti për licencim, ka njoftuar se 11 kompanitë tjera nuk kanë aplikuar ende.

22. REGJISTRIMI I BIZNESEVE TË REJA në komunat veriore të Kosovës

Administrata Tatimore e Kosovës ka raportuar se 191 biznese të reja janë regjistruar në katër komunat veriore të Kosovës në gjashtë muajt e fundit.

Të gjitha këto kompani janë të regjistruara sipas Ligjit të Kosovës. Është shënuar një bashkëpunim dhe koordinim i mirë rreth kësaj çështje ndërmjet Doganës së Kosovës, Administratës Tatimore të Kosovës dhe bizneseve lokale nga komunat veriore.

	Komuna	Gjithsej kompani të regjistruara
1.	<i>Leposaviq</i>	65
2.	<i>Z. Potok</i>	27
3.	<i>Zveçan</i>	39
4.	<i>Mitrovica Veriore</i>	60
	<i>Gjithsej</i>	191

Zbatimi i marrëveshjeve të Brukselit jo vetëm që ndihmoi vendosjen e sundimit të ligjit në këtë vend dhe reduktoi ekonominë joformale, por gjithashtu ka siguruar edhe një burim shtesë për investime zhvillimore në pjesën veriore, për të cilat Qeveria e Kosovës mbetet e përkushtuar.

Regjistrimi i kompanive të reja të eksportit / importit

Bazuar në raportet e Doganave të Kosovës, 18 kompani të reja janë regjistruar për eksport dhe import të mallrave në katër komunat veriore. Të gjitha dokumentet e paraqitura nga ato kompani tek Doganat e Kosovës janë në përputhje me ligjet e Kosovës në fuqi. Gjithashtu, vlen të theksohet se 99% e importuesve të regjistruar në sistemin Asycuda në veri janë të pajisura me numra fiskal dhe të biznesit, në përputhje me ligjin e Kosovës dhe Marrëveshjen e Brukselit për Vjeljen e të Ardhurave Doganore të 17 janarit 2013.

23. CERTIFIKATAT ADR

Marrëveshja për njohjen reciproke të certifikatave ADR (Certifikata mbi mallrat e rrezikshme), është arritur në Bruksel më 19 prill 2016, pas tetë muajsh të bllokadave të bëra nga autoritetet e Serbisë për kompanitë kosovare të importit-eksportit që transportojnë mallra të rrezikshme. Që nga 25 prilli 2016, Marrëveshja për ADR është në fuqi dhe është zbatuar në mënyrë korrekte sipas konkluzioneve të dakorduara mes palëve dhe deri më tani nuk është raportuar asnjë problem.

Në përgjigje ndaj bllokadës serbe, janë vendosur masat e reciprocitetit nga Qeveria e Kosovës më 23 mars 2016, të cilat bënë që Serbia të pranojë marrëveshjen. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë e Kosovës, më 25 Prill 2016 ka shfuqizuar vendimin për masat e reciprocitetit.

Për arritjen e kësaj marrëveshjeje, ka pasur dy takime të grupit të punës të organizuara nga BE-ja për të gjetur marrëveshje të mundshme. Takimi i parë u mbajt në Vjenë më 4 prill të vitit 2016 pa rezultate dhe në takimin e fundit në Bruksel më 19 prill 2016, marrëveshja për njohjen e ndërsjellë të certifikatave ADR.

Për më shumë informacion mbi këtë proces, marrëveshjet dhe raportet e mëparshme periodike, ju lutem referojuni në faqen zyrtare të Qeverisë së Kosovës:

<http://www.kryeministriks.net/?page=2,252>

Lista e shkurtesave

ADR- Marrëveshja Evropiane mbi Transportin Ndërkombëtar Rrugor të Mallrave të Rrezikshme
ASYCUDA - Sistemi i Automatizuar për të Dhënat Doganore
PKK - Pikë Kalim Kufitar
KQZ - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Kosovës
CEFTA - Marrëveshja e Evropës Qendrore për Tregti të Lirë
KiB - Këshilli i Byrove/Organizata Menaxhuese e Sistemit të Kartonit të Gjellbër dhe Direktivave të Sigurimit të mjeteve motorike
MC - e ashtuquajtura 'Mbrojtja Civile'
ÇPF - Certifikata e Produkteve Farmaceutike
ARC - Agjencia për Regjistrim Civil e Kosovës
LRC-Libri i Regjistrimit Civil
DRC - Këshilli Danez për Refugjatë
EEAS - Shërbimi Evropian për Veprim të Jashtëm
EED - Dokument për Hyrje/Dalje
EMS - Operatori Serb i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut
ENTSO - Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmisionit të Energjisë Elektrike
ZRRE- Zyra e Rregullatorit të Energjisë së Kosovës
BE - Bashkimi Evropian
EUA - Asociacioni Evropian i Universiteteve
EUA - Asociacioni Evropian i Universiteteve
EULEX - Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
PSBE - Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian
FBK - Federata e Basketbollit të Kosovës
FIBA - Federata Ndërkombëtare e Basketbollit
FIFA - Fédération Internationale de Football Association
MLL- Marrëveshja për Lëvizje të Lirë
QK - Qeveria e Republikës së Kosovës
PL - Përfaqësuesja e Lartë e Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe të Sigurisë
MIK - Menaxhimi i Integruar i Kufirit
GI - Grupi Implementues
IPA - Instrumenti i BE-së për Asistencën e Para-anëtarësimit
ITU - Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit
KEDS - Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me energji elektrike
KESCO -Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike SH.A
KGJK - Këshilli Gjyqësor i Kosovës
AKPPM - Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale
KOSTT - Operatori Kosovar i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut
PK - Policia e Kosovës

KPK - Këshilli Prokurorial i Kosovës
AKKVP - Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës
AKKVP- Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës
ZN - Zyrtari Ndërlidhës
MARRI - Iniciativa Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë
MZHE - Ministria e Zhvillimit Ekonomik e Kosovës
MMPHK -Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e Kosovës
MBP - Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës
NNJ - Ndihma e Ndërsjellë Juridike
MAPL - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e Kosovës
ZAMV - Zyra Administrative e Mitrovicës Veriore
MiM - Memorandum i Mirëkuptimit
OSBE - Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
KM - Kryeministri
ARKEP- Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare të Kosovës
RKS - Republika e Kosovës
SEECp -Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore
SEED - Sistemi për Shkëmbimin e të Dhënave të Akcizës
NVM - Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
SPARK - Organizatë holandeze jo-qeveritare
GTI - Grupi Trepalësh për Implementim
TPL - Sigurimi i Përgjegjësisë ndaj palës së tretë
OST - Operatori i Sistemit të Transmisionit
UEFA- Unioni i Federatave Evropiane të Futbollit
UNESCO - Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukim, Shkencë, dhe Kulturë
UNMIK - Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
UNOPS - Zyra e Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve